



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:036233

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06037573

KPPP.nr.2320/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Unique” SH.P.K., me numër unik identifikues 810199978 me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ibrahim Dobruna, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Toëer Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 810873027 me seli në Shtime, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Bajrami, avokat nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.08/2024 të datës 15.01.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Isak Islami, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 09.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Toëer Group” SH.P.K., ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbaremore P.nr.08/2024, i lejuar më datë 15.01.2024, nga Përmbareuesi Privat Isak Islami, dhe PËRFUNDOHET procedura përmbaremore.
- II. OBLIGOHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 104 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Unique” SH.P.K., ka lëshuar Urdhri Përmbaremore P.nr.08/2024 të datës 15.01.2024 me të cilin e ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës së datës 24.09.2021, transaksionit bankar të datës 13.10.2021 si dhe komunikimit elektronik, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 6,254.00€

si dhe shpenzimet tjera të procedurës nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, këtë përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimit, sekuestrimin dhe vlerësimin të paluajtshmërive.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se lejimi i përmbarimit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas debitorit fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk është e përshtatshme për përmbarim, përkatësisht kundër lëshuesit të saj. Ka shtuar se përmbarimi mund të lejohet vetëm duke u bazuar në dokumentin e besueshëm dhe se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit si dhe të shfuqizoj urdhrin përmbarimor. Po ashtu ka kërkuar shpenzimet për paraqitjen e prapësimit sipas tarifës së OAK-së, në shumë prej 312€.

Kreditori brenda afatit ligjor, përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit ku ka theksuar se debitori si rrjedhojë e marrëveshjes me kreditorin ka përfituar shumë në vlerë prej 6,254.00€, mirëpo asnjëherë nuk i ka ofruar shërbimin e kontraktuar kreditorit. Kreditori thekson se ka realizuar pagesën ndaj debitorit mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar shërbimin e kontraktuar, andaj ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lejoj përmbarimin, gjegjësisht kthimin e borxhit në shumë prej 6,254.00€, borxh të cilin kreditori e ka paguar mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar shërbimin sipas marrëveshjes. Ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 262.69€ për përpilimin e propozimit për përmbarim dhe shumë prej 245.00€ për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Urdhrin Përmbarimor P.nr.08/2024 i datës 15.01.2024, bazohet në Faturën e datës 24.09.2021, në të cilën faturë kreditori në këtë procedurë përmbarimore ka cilësinë e debitorit, ndërkaq debitori në këtë procedurë përmbarimore në faturë ka cilësinë e kreditorit.

Ndërkaq, transaksioni bankar i datës 13.10.2021, mbi bazën e së cilit është lejuar përmbarimi, me të cilin debitori vërteton se ka paguar borxhin ndaj debitorit në shumë prej 6,254.00€, nuk përbën titull ekzekutiv, meqenëse i njëjti nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm e as dokument përmbarimor konform dispozitave të LPP-së.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se kjo procedurë përmbarimore nuk është iniciuar mbi asnjërën bazë të përmbarimit të përcaktuar me dispozitat e nenit 21, 22 apo 29 të LPP-së.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12.2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*,

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimin të ushtruar, në vlerë prej 104 € konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.223/24, datë 09.08.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.